



KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 103 Akti

Nr. 117 Vendimi
Tiranë, më 21.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine
Suela Zhegu
Brunilda Bekteshi

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 21 mars 2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ornela J. Naqellari, me funksion gjyqtare/ Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cili pranoi rezultatet e hetimit dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, me funksion gjyqtare/Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u hedhur në short si subjekt, me shortin e hedhur, më datë 15.03.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.03.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar, z. John Leonardo.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD).

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari”*.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 05.03.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, znj. Ornela Naqellari, i janë garantuar të drejtat, si: për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ në datën 5 mars 2019, duke i kërkuar shpjegime mbi rezultatet e hetimit. Për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, ju dha tre ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Znj. Ornela Naqellari, u njoh me rezultatet e hetimit dhe ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj, më datë 08.03.2019. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit, u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 11.03.2018. Trupi gjykues, pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, me shumicë votash vendosi rihapjen e hetimit për marrjen e provave të reja. Gjatë kësaj kohe u depozituan

² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin KDZH-së, nr. *** , datë 11.04.2018.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.04.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

denoncime nga publiku me të cilat subjekti i rivlerësimit u njoh me to, paraqiti shpjegime dhe dokumentacion mbështetës. Pas rihapjes së hetimit trupi gjykues pranoi **Gjetjen**⁴ e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, Z. John Leonardo, lidhur me çështjen konkrete që po shqyrtohej nga trupa, si dhe **Opinionin**⁵ e tij, me të cilat subjekti i rivlerësimit u njoh. Pas mbylljes së hetimit administrative, më datë 18.03.2019, subjekti u ftua sërish në seancën dëgjimore të datës 21.03.2019.

Seancat dëgjimore u zhvilluan më datat 11.03.2019 dhe 21.03.2019, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Znj. Ornela Naqellari ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.03.2019.

me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces i mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit në ILDKPKI;
- (ç) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja;
- (dh) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLD;
- (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- (f) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, me funksion gjyqtare/Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

1. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, është bërë subjekt deklarues në vitin 2009 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private nga viti 2009 - 2016 si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Në deklaratën e pasurisë sipas formularit (shtojca 2) të datës 29.01.2017, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela J. Naqellari, ka deklaruar këto pasuri:

1.1 Pasuri e paluajtshme tokë e llojit “arë”, “pemëtore” dhe “vresht”, zotëruese me 1/5 pjesë, ndodhur në Përmet, e fituar sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, të regjistruara në ZVRPP-në Përmet, sipas certifikatave për vërtetim pronësie, datë 26.09.2002, në bashkëpronësi me familjarët sipas certifikatës familjare. Përkatësisht, pasuritë e deklaruara sa më poshtë:

- me nr. ***, e llojit arë, me sip. 3530 m²;
- me nr. ***, e llojit arë, me sip. 2320 m²;
- me nr. *** e llojit pemëtore, me sip. 450 m²;
- me nr. *** e llojit vresht, me sip. 2436 m².

Në dosjen e hetimit të ILDKPKI-së rezulton shkresë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Përmet⁶, e cila ka konfirmuar këtë pasuri, në pronësi të shtetases L.K. N. (nëna e subjektit), përkatësisht:

- Pasuri me nr. *** e llojit pemëtore, me sip. 450 m², ndodhur në ZK ***, Ndërmarrja Bujqësore Përmet 2;
 - Pasuri me nr. *** e llojit “arë”, me sip. 3530 m² ndodhur në ZK *** NB Përmet 2.
 - Pasuri me nr. *** e llojit “vresht”, me sip. 2436 m², ndodhur në ZK ***NB Përmet 2.
 - Pasuri me nr. *** e llojit “arë”, me sip. 2320 m², ndodhur në ZK *** NB Përmet 2.
- ✓ Nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se, sipërfaqet e tokës të deklaruar nga subjekti përputhet me sipërfaqet e përshkruara në certifikatat për vërtetim pronësie.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje:

- Në dokumentin e AMTP-së, pasi kjo pasuri figuron e regjistruar me emrin “L.” dhe jo “L.” siç paraqitet emri i nënës së subjektit në certifikatën familjare, datë 27.01.2017, lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. **, Tiranë.
- Në dokumentin e AMTP-së, ka mospërputhje të sipërfaqeve të dhëna përfitueses me sipërfaqet e cituara në dokumentin hipotekor, ku rezultojnë 136 m² më tepër sipërfaqe tokë bujqësore.

Komisioni, duke analizuar këto fakte vëren se, mospërputhjet e konstatuara nuk lidhen me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, dhe në këto kushte ato duken si gabime materiale në plotësimin e aktit nga ana e institucionit që kanë lëshuar këtë dokument.

1.2 Automjet i tipit “Skoda Fabia”, Ambiente 1.2 TSI, me pjesë takuese 100 %, me vlerë 11.500 euro, sipas kontratës së qirasë financiare të vitit 2012 me pronar - qiradhënës “Raiffeisen Laesing” sh.a. Paradhënia e paguar në shumën prej 4.600 eurosh, nga shtetasi A. M. (i fejuari i subjektit) bashkëpërdorues.

Subjekti ka deklaruar burimin e krijimit: paradhënia në shumën prej 4.600 eurosh, paguar nga shtetasi A.M. (i fejuari i subjektit), bashkëpërdorues, paguar me kursimet e të atit shtetasit

⁶ me shkresën nr. *** prot., datë 25.07.2017.

E. M. Pagesa e kësteve mujore në llogarinë nr. ***, në euro, në “Raiffeisen Bank” sh.a. nga shtetasi A. M. bashkëpërdorues dhe kryesisht nga subjekti, në bazë të të ardhurave nga paga.

Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor⁷, ka konfirmuar automjetin në pronësi të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornella Naqellari, me targë AA *** DT, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fotokopje e pronësisë së automjetit si dhe kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 18.05.2016.

- ✓ Komisioni vëren se, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Leasing” sh.a., dhe DPSHTRR-së.

Komisioni i ka kërkuar subjektin, burimin e ligjshëm për paradhënien në shumën prej 4.600 euro, të paguar nga i “fejuari” z. A. E. M, për blerjen e automjetit.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Paradhënia në shumën 4.600 euro është paguar nga shtetasi A. M. si bashkëpërdorues, në bazë të kursimeve të të atit, shtetasit E.M. Kursimet janë krijuar në bazë të të ardhurave nga aktiviteti tregtar dyqan që nga viti 2000 e në vijim dhe puna e kryer nga prindërit e të fejuarit ndër vite. Kursimet i kanë mbajtur të depozituara në bankë disa vite përpara se unë të emërohesha gjyqtare”.*

Nga dokumentacioni bankar lëshuar nga “Banka Kombëtare Tregtare”, “Nxjerrje Llogarie”, më datë 07.01.2019, rezulton se z. E. M. figuron titullar i një “depozite”, çelur më datën 26.05.2006, në shumën 2.350.000 lekë.

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, ka konfirmuar se z. E. M. ka disponuar bono thesari, që nga viti 2009, e në vijim, në shumën prej 2.400.000 lekësh. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare, rezulton se z. E. M. ka pakësuar shumën e likuiditeteve, më datë 30.03.2012, disa ditë përpara, se të bëhej pagesa prej 4.600 euro, për automjetin tip “Scoda Fabia”.

- ✓ Komisioni, nga hetimi i kryer ka konstatuar se, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (i fejuari), ka pasur mundësi financiare për të kryer pagesën, si paradhënie për automjetin.

1.3 Kursime cash nga paga, në shumën prej 250.000 lekësh.

Komisioni, bazuar në analizën financiare vëren se, kursimet nga paga e mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti.

1.4 Llogari rrjedhëse e subjektit e përbashkët me znj. L. N. në euro, pranë “Tirana Bank” për transferta/dërgesa nga z. J. N. babai i subjektit emigrant prej 20 vitesh në shtetin Grek (të ardhura për familjen). Gjendja e llogarisë 32.26 euro, më datë 24.01.2017.

Nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se:

⁷ Me shkresën nr. *** prot.⁷, datë 24.04.2018, nr. *** prot., datë 30.04.2018

“**Tirana Bank**”⁸, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela J. Naqellari, në monedhën euro. Në këtë llogari figuron dhe emri i znj. L.K. N. e cila ka të drejtë të kryejë veprime në këtë llogari. Gjendja e llogarisë 0 euro.

Komisioni hetoi mbi burimin e ligjshëm të transfertave të dërguara nga babai i subjektit. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 10.01.2019, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të deklaruara nga z. J. N. pranë autoriteteve greke, për periudhën e viteve nga emërimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit viti 2009 e në vijim. Dokumentacioni mbi punësimin e ligjshëm të babait dhe të ardhurave të përfituara janë të legalizuara me vulë apostile nga prefektura e Kavallës dhe janë përkthyer e noterizuar.

- ✓ Komisioni vëren se dokumentacioni i administruar, jep informacion për të ardhura të ligjshme nga punësimi, të cilat tregojnë burime të ligjshme, të krijuara nga babai i subjektit.

1.5 Llogari rrjedhëse në lekë, pranë “Raiffeisen Bank”, me gjendje në datën 30.12.2016, në shumën prej 54,662 lekësh. Pjesa zotëruese: 100%.

“Raiffeisen Bank”⁹ ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie page.

1.6 Llogari rrjedhëse në euro, pranë “Raiffeisen Bank”, me gjendje llogarie, më datë 16.06.2016, në vlerën 0.11 euro. Pjesa zotëruese: 100%.

“Raiffeisen Bank”¹⁰ ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie.

Analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit 2009 - 2016

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1. Të ardhurat	721 537	796 924	1 042 148	1 712 464	1 066 358	1 375 075	1 298 106	1 425 852
2. Shpenzimet	194 359	229 840	455 436	526 380	427 736	392 993	482 951	255 287
3. Ndryshim likuiditeti	-12 070	-15 633	-44 455	-57 628	36 587	78 681	215 883	191 162
4. Pasuri Neto	0	-250 000	-133 760	573 896	339 700	211 810	275 195	474 806
Diferenca (1-2-3)	539 248	832 717	764 927	669 816	262 336	691 592	324 076	508 961

Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje ka rezultuar se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit ka krijuar një pasuri e cila konsiston në likuiditete, në vlerën prej 250,000 lekësh, *cash*, si dhe një autoveturë e blerë në vitin 2016 sipas kontratës me “Raiffeisen Leasing”, me vlerë prej 11,500 eurosh.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve, përgjatë viteve të punësimit.

1.7 Bashkëkredimarrëse me të motrën E. J. N. sipas kontratës së kredisë bankare të vitit 2010 dhe 2011, pranë “Raiffeisen Bank”. Këstet e kredisë janë paguar me të ardhura të

⁸me shkresën nr. *** prot., datë 17.04.2018.

⁹ Shiko në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 16.04.2018, ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁰ Shiko në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 16.04.2018, ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

familjarëve dhe të ardhurat e E. N. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer, më datën 25.01.2017, është 188,079 lekë.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

“Raiffeisen Bank”¹¹, ka konfirmuar se, znj. Ornela J. Naqellari dhe znj. E. N, kanë qenë bashkëkredimarrëse për shumën 500.000 lekë, disbursuar në datë 29.06.2010, si dhe kredinë me shumë 712,866.5 lekë,¹² disbursuar në datë 04.07.2011.

Nga analiza financiare ka rezultuar se,

- ✓ Subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të përballuar shpenzimet gjatë periudhës 2009 - 2016, si dhe të paguajë këstet e kredive.

Deklarimi i personit të lidhur – motra e subjektit, znj. E. N.

1.8 Llogari rrjedhëse në monedhën lekë, pranë Bankën Kombëtare Tregtare, në emër të motrës së subjektit, znj. E. J. N. person fizik, sipas gjendjes së llogarisë, datë 21.01.2017, në vlerën 39.800 lekë. Pjesa zotëruese: 100 %.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se, “BKT”-ja¹³ ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie rrjedhëse.

1.9 Gjendje cash, në monedhën lekë, në datën e deklaramit 29.1.2017, në vlerën 300,000 lekë, me burim të ardhurat nga punësimi dhe vetëpunësimi. Pjesa zotëruese: 100 %.

Komisioni, bazuar në analizën e kryer vëren se, të ardhurat e realizuara nga punësimi mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar nga personi i lidhur, motra e subjektit.

Subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e personit të lidhur, znj. E. N¹⁴ dhe dokumentacion mbi punësimet e saj, si më poshtë:

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.04.2018.

¹² Kredia e dytë është përdorur pjesërisht për mbylljen e kredisë së parë.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., 25.04.2018.

¹⁴ Bashkëlidhur deklaratës ndodhet dokumentacioni si më poshtë:

- Kërkesë datë 20.12.2016 e Av. E. N. drejtuar Drejtorisë së Agjencisë së Planifikimit të Territorit për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit justifikues (deklaratë/vërtetim mbi të ardhurat neto, nga pagat dhe shërbimi si ekspert prokurimesh pranë AKPT për periudhën e ofrimit të këtij shërbimi në total); Dëftesa për pranimin e objekteve postare, datë 22.12.2016, me dërgues E. N. dhe marrës Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, objekti – letër.

- Dëftesë për pranimin e objekteve postare, datë 22.12.2016, me dërgues E. N. dhe marrës Agjencia Kombëtare e Barnave dhe pajisjeve mjekësore, objekti – letër. Kërkesë datë 20.12.2016 e av. E. N. drejtuar Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Urdhër nr. *** prot., datë 20.4.2015, i AKPT, Drejtore e Përgjithshme A. G nëpërmjet të cilit urdhërohet E. N.(eksperti) për lidhjen e kontratës së shërbimit për ekspertizë në kryerjen e procedurave të prokurimit për llogari të AKPT (klienti), sipas kërkesës për ofertë të klientit dhe ofertës së paraqitur dhe pranuar të ekspertit; Kontratë shërbimi AKPT, nr. *** prot., datë 20.4.2015 ndërmjet palëve AKPT-së dhe znj. E. N. Vlera e shërbimeve për kryerjen e detyrave ..., për 1 (një) procedurë prokurimi është 75,000 lekë.

- QKB-ja, certifikatë regjistrimi, person i tatuësoshëm: E. N. - Person Fizik, me adresë: Rr. “****”, pallatet “****” hyrja A**, kati **. NUIS L***K, datë regjistrimi 09.09.2015, datë lëshimi certifikate 10.9.2015; Ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person fizik” E. N. NUIS L***K, fusha e veprimtarisë “Avokat” me status aktiv dhe datë regjistrimi 09.09.2015.

- Shkresa nr. *** prot., datë 13.1.2017, DRT-së Tiranë, Drejtoria e Kontrollit Tatimor e cila konfirmon se Tatimpaguesi E. N. për periudhën shtator – 31 dhjetor 2015, ka realizuar xhiro në shumën 266,665 lekë dhe për periudhën 1 janar – 30 nëntor 2016, ka realizuar xhiro në shumën 360,829 lekë. (Kërkesë datë 20.12.2016 e Av. E. N. drejtuar DRT Tiranë). Shuma totale 627,494 lekë.

- ISSH-së, me shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2017, ka konfirmuar të ardhurat financiare bruto dhe neto të realizuara nga viti 2012 e vazhdim, për shtetasen E. J. N.

Të ardhurat e realizuara nga E. N. janë:

- për vitin 2012 në shumën 654,752 lekë;

- Në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (ish Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave) në detyrë “Specialist jurist” për periudhën Qershor 2005 deri në Mars 2014.
- Në Agjencinë e Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në detyrë “Specialist i Jashtëm në fushën e prokurimeve”, me kontratë shërbimi, për periudhën prill - nëntor 2015.
- Vetëpunësimi në aktivitet privat, znj. E. N. person fizik, me adresë: Rr. “****”, pall. “****”, hyrja A**, Ap. **, Tiranë, me NUIS: L***K, me objekt veprimtarie “shërbime avokatie” me nr. licence ***, regjistruar në datë 09.09.2015, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, statusi aktiv. Xhiro neto e realizuar gjithsej për periudhën shtator 2015 - nëntor 2016, sipas shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore në vlerën 627,494 lekë.

1.10 Detyrime tatimore në total, të subjektit tatimor E. N. person fizik, me NUIS: L*K, ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, më datë 28.01.2017, paraqiten në shumën prej 117,036 lekësh.**

DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.04.2018, ka konfirmuar se shtetasja E. J. N. me nr. kartë identiteti ID I***Q, për periudhën janar 2012 - dhjetor 2017, ka realizuar të ardhura nga punësimi si dhe ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Znj. E. N. me NUIS L***K, është e regjistruar pranë organit tatimor, më datë 09.09.2015, me aktivitet “Avokate”. Për periudhën 09.09.2015 - 31.12.2017 ka ushtruar aktivitet dhe ka të dhëna. Për periudhën tatimore 2017, znj. E. N. rezulton se ka realizuar të ardhura në shumën prej 358.001 lekësh. Për periudhën e verifikuar rezulton se, subjekti E. J. N., me NUIS L***K, ka deklaruar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

1.11 Deklarimi i personave të lidhur – babai, nëna, vëllai.

- Z. J. N, babai i subjektit, ka nënshkruar autorizimin e personit të lidhur dhe ka plotësuar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas.
- Znj. L.N. nëna e subjektit, ka nënshkruar autorizimin e personit të lidhur dhe ka plotësuar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas.
- Z. J. N. vëllai i subjektit, ka nënshkruar autorizimin e personit të lidhur dhe ka plotësuar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Përmet¹⁵, ka konfirmuar këtë pasuri, në pronësi të shtetasës L. K. N. (nëna e subjektit).

Komisioni vëren se, personi i lidhur, znj. L. N. ka kryer deklaram të pasaktë në përputhje me ligjin. Por gjithashtu, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe e motra si pasuri e përfiturar me ligjin nr. 7501/1991, nëpërmjet AMTP-së dhe është pasuri e pandarë, si dhe nuk ka investim monetar nga familja e subjektit sepse është përfiturar për shkak të ligjit.

- për vitin 2013 në shumën 557,861 lekë;
 - për vitin 2014 në shumën 54, 960 lekë;
 - për vitin 2015 (aktivitet privat) në shumën 61,776 lekë;
 - për vitin 2016 (aktivitet privat) në shumën 86,040 lekë.

¹⁵ me shkresën nr. *** prot., datë 25.07.2017.

- ✓ Komisioni vlerëson se është një pasaktësi në plotësim të deklaratës nga personi i lidhur, nëna e subjektit, por nuk mund të provohet të jetë kryer me qëllim fshehjen nga ana e saj.

1.12 Komisioni hetoi lidhur me regjistrimin e parë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, në Njësinë Administrative Nr. ** Tiranë.

Njësia Administrative Nr. ** Tiranë¹⁶, ka informuar se nuk disponohen dokumente regjistrimi në këtë njësi për subjektin, sepse sipas VKM-së 1243, datë 11.12.2009, këto dokumente ruhen për një afat 5-vjeçar. Sipas të dhënave nga regjistri themeltar ***, nuk figuron asnjë adresë e shtetases e regjistruar nga data 22.01.2005, në Njësinë Administrative Nr. **, Tiranë, ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile Përmet. Sipas të dhënave nga regjistri kombëtar i gjendjes civile të vitit 2010, vërehet se, më datë 24.08.2017, ka bërë ndryshim vendbanimi dhe nga kjo datë e në vijim subjekti është banore e Njësisë Administrative Nr. **, Rr. “***”.

Nga hetimi i kryer në tërësi, Komisioni vëren se, nuk disponohen të dhëna apo ndonjë indice, ku mund të ngrihen dyshime në lidhje me banesat e përdorura nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve dhe sipas dokumentacionit të ardhur ka rezultuar se:

1.13 ZVRPP-ja Tiranë dhe ZVRPP-të në rrethe, konfirmojnë se në emër të subjektit dhe personave të lidhur sipas certifikatës familjare, nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara.

1.14 ALUIZNI¹⁷, konfirmon se nga verifikimet e kryera në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, shtetësja Ornela J. Naqellari dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

1.15 “Banka e Shqipërisë”,¹⁸ “BKT”, “Intesa Sanpaolo Bank”, “Alpha Bank”, “NBG”, “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, “Banka Ndërkombëtare Tregtare”, “Procredit Bank”, “Fibank”, “Banka Amerikane e Investimeve”, “Banka e Kreditit të Shqipërisë”, “Credins Bank”, “Veneto Bank”, “Union Bank”, “Porche Leasing” sh.p.k., “Raiffeisen Invest”, “Credins Invest”, konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari dhe personat e lidhur me të, E. J. J. dhe L. N. nuk janë klientë të tyre.

1.16 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave¹⁹, konfirmon se: Nga verifikimi i të dhënave për shtetasit Ornela Naqellari, dhe personat e lidhur me të, E. J. J. dhe L. N. nuk rezultojnë të dhëna të raportuara.

1.17 Qendra Kombëtare e Biznesit²⁰, konfirmon aktivitet të regjistruar në emër të shtetases E.N. e datëlindjes 29.05.1981, regjistruar si person fizik pranë QKB-së, më datë 09.09.2015, pajisur me NUIS L***K.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 05.02.2019.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.04.2018.

¹⁸ Referoju kthim përgjigjeve në dosje.

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.04.2018.

²⁰ me shkresën nr. *** prot., datë 14.05.2018.

1.18 Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike²¹, konfirmon se subjekti Ornela Naqellari dhe personat e lidhur E. J. J. dhe L. N. nuk figurojnë abonent familjar me kontratë për furnizimin me energji elektrike.

1.19 Ujësjellës Kanalizime Tiranë²², konfirmon se në emër të subjektit Ornela Naqellari, dhe personat e lidhur me të, E. J. J. dhe L. N. nuk figurojnë abonentë familjarë me kontratë për furnizimin me ujë.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR MBI PASURINË

Për sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

2. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin, me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 11.04.2018), për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari”*.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3. VLERËSIMI PROFESIONAL

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet në periudhën 2010 – 2016. Nga data 30.05.2016 e ka ushtruar këtë funksion pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe nga shtatori i vitit 2016 e në vijim ushtron edhe funksionin e kryetares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²¹ me shkresën nr. *** prot., datë 06.11.2018.

²² me shkresën K-*** prot., datë 30.10.2018.

Raporti i vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe është bazuar mbi analizimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

KLD-ja, në vlerësimin profesional për subjektin është bazuar në: Formularin e vetëdeklarimit, tri dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Raporti i sjellë nga ky institucion, përmban:

GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

- a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.
- b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit: Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se, më datë 30.06.2005, znj. Ornela Naqellari, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2009. Pas studimeve, më datë 25.06.2010, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatësë Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendimin nr. 59, datë 27.05.2016, të KLD-së, është transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Më datë 16.09.2016, delegohet si kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë deri më 18.11.2016, dhe me vendimin nr. 128 të KLD-së është emëruar në detyrën e kryetares, ku vazhdon dhe aktualisht.
- c) Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit znj. Ornela Naqellari, ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 843 çështje, ka përfunduar gjithsej 704 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 81 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 83,5 %.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Ornela Naqellari, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore pranë KLD-së.

a. Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, ndonëse në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë apo nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale, i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij.

Subjekti i rivlerësimit ka njohuri të procedurave të gjyqimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit, e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar katër prej tyre. Në katër raste, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve. Ndërsa në katër rastet e tjera, nuk është ushtruar ankim nga palët. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Ornela Naqellari, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore²³.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast në aktet e vëzhguara që të jetë cenuar vendimi nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

b. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit znj. Ornela Naqellari, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe prej datës 30.05.2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjithashtu, nga shtatori i vitit 2016 ka kryer edhe detyrën e kryetares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, njëkohësisht në dhomën civile e penale.

²³ Referuar të dhënave nga Burimet Arkivore të KLD-së.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat nga KLD-ja, konstatohet se, gjyqtarja Ornela Naqellari, ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, por i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimit dhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së së tyre. Në katër çështje civile të vëzhguara, subjekti ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore efektive, të cilat i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në katër çështje civile, gjykimet kanë përfunduar me 1 - 6 seanca. Ndërsa çështja penale e vëzhguar, që lidhet me veprën penale krim, është përfunduar me 3 seanca.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile ose penale. Në çdo dosje të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezultojnë se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, gjithashtu të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë.

Në dosjen 1 dhe 5 aktet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale e civile dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët.

c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Ornela Naqellari. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative në këtë aspekt. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari. Në dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

ç. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Ornela Naqellari komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale në komunikim, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarës dhe as kërkesa të vetë gjyqtarës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

IV. DENONCIME PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT

Denoncim nr. 1²⁴, depozituar nga noterja, znj. L. B.

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të paligjshme kërkon që, për të favorizuar një palë në gjyq dhe për të dëmtuar një palë tjetër, të lëshohet një dëshmi trashëgimie pa respektuar procedurën ligjore.

Nga verifikimi i çështjes ka rezultuar se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë ishte duke u gjykuar çështja civile me paditës, P.Sh. dhe të paditur, P. K. etj., me objekt: "Anulimin e vendimit nr. 39/1, të KKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Mirditë...".

Për shkak se njëri prej të paditurve, me inicialet P.K., ka ndërruar jetë e për pasojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në zbatim të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile ka "pezulluar gjykimin e çështjes" dhe i është drejtuar noterës L.B., për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë, si zyra përgjegjëse për lëshimin e këtij akti.

Komisioni, duke analizuar shkresat ka evidentuar se: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e ndërmjetëm të datës 05.07.2017, referuar nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur kryesisht pezullimin e gjykimit dhe i është drejtuar noterës L.B., duke i kërkuar: *"Që të merren masa për të proceduar me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të paditurin P.K. dhe menjëherë pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë të njoftojë gjykatën dhe t'i paraqesë dëshminë e trashëgimisë në mënyrë që gjykata të rifillojë gjykimin e çështjes"*. Gjykata e ka mbështetur kërkesën, në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për Noterinë", të ndryshuar, në nenin 53/1, ku parashikohet se: *"Noteri mban origjinalin e dëshmisë së trashëgimisë dhe i lëshon kërkesit ose çdo personi, që ka një interes të ligjshëm, një ose disa kopje të dëshmisë së trashëgimisë, të njehsuara me origjinalin"*. Nga kërkesa e gjykatës drejtuar noterit citohet se: *"Gjykata i ka dërguar noterës L.B., certifikatat e lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile, në formën e kërkuar nga ligji"*.

Trupi gjykues vendosi, më datë 15.03.2019, të thërras noterën L.B, me cilësinë e dëshmitarit. Znj. B. nuk pranoi të paraqitej para Komisionit për të dëshmuar. Në këto kushte, subjektit të vlerësimit iu vunë në dispozicion provat e paraqitura nga denoncuesja (noteria) dhe depozitot shpjegimet dhe provat, nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 15.03.2019.

Në lidhje me këtë çështje, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019, ka paraqitur "Gjetje" ku ndër të tjera shprehet se, denoncimi i depozituar nga noteria ka të bëjë me një çështje në shqyrtim dhe për këtë arsye ky denoncim dhe çdo provë që lidhet me të nuk qëndron për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe nuk duhet të shqyrtohet nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²⁴ me shkresën nr. *** prot., datë 25.04.2018.

Trupi gjykues pasi analizoj çështjen në tërësi, vlerësoi se, kjo çështje është në gjykim dhe referuar paragrafit të fundit të pikës 2, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, thuhet shprehimisht se, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

Denoncim nr. 2²⁵, depozituar nga z. Gj.D.

Denoncuesi pretendon se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, roja i sigurisë D.P është person i dënuar me vendim gjyqësor, por edhe pse ky person është i dënuar me vendim penal vazhdon akoma dhe sot të mbahet në punë, me miratimin direkt të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, në cilësinë e kryetares së gjykatës.

Komisioni nga verifikimi i kryer në lidhje me këtë denoncim, ka rezultuar se shtetasi D. P, me vendimin nr. 107, datë 18.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i akuzuar për veprën penale të “Prishjes së qetësisë publike”, neni 274 i Kodit Penal është deklaruar fajtor dhe është dënuar me gjobë në vlerën 40.000 lekë. Në vijim, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 40, datë 11.02.2013, ka vendosur: Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit D. P. Nga dokumenti “vërtetimi i gjendjes gjyqësore” me nr. *** prot., datë 28.05.2014, ka rezultuar se shtetasi D. P është i padënuar.

Komisioni ka konstatuar se, personi për të cilën denoncuesi pretendon se është i dënuar, rezulton i padënuar penalisht si dhe nuk provohen pretendimet që ngre denoncuesi ndaj subjektit të rivlerësimit.

Denoncim nr. 3²⁶, depozituar nga znj. L.V, për shkelje të ligjit procedural dhe material.

Denoncuesja pretendon se, subjekti i rivlerësimit, ka ndërhyrë në sistemin elektronik të gjykatës për të bërë ndryshime në datën dhe orën e seancës gjyqësore në çështjen në të cilën znj. V. ka qenë si palë ndërgjyqëse. Subjekti pasi u njoh me këtë denoncim ka shpjeguar se është një gabim i sekretarisë, ku është hedhur gabim data e gjyqit në sistem elektronik të gjykatës, por denoncuesja edhe pse nuk kishte flete-thirrje nga gjykata, është paraqitur duke iu referuar faqes elektronike të gjykatës.

Komisioni vëren se pretendimet e denoncueses nuk mund të provohen.

Denoncim nr. 4, përsëri znj. L. V paraqet një denoncim të dytë, për subjektin e rivlerësimit.

Denoncuesja pretendon se në vitin 2017, kjo gjyqtare ka gjykuar një çështje gjyqësore civile ku denoncuesja ka qenë palë paditëse, dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë²⁷, vendim të cilin Gjykata e Apelit Shkodër, e ka ndryshuar. Denoncuesja pretendon se Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është marrë në kundërshtim të hapur me ligjin. Për këtë çështje është ushtruar dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, dhe ndodhet në pritje për tu gjykuar.

Komisioni nuk ka gjetur të dhëna në dosje që të mbështesin këtë denoncim.

Denoncim nr. 5²⁸, depozituar nga zj. A.K, kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²⁵ me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018.

²⁶ me shkresën nr. ***prot., datë 24.12.2018.

²⁷ me vendimin nr. *** (***) , datë 26.12.2017, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁸ me shkresën nr. *** prot., datë 28.01.2019, me e-mail-in datë 13.03.2019, me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019.

Kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në denoncimin e paraqitur ka pretenduar një sërë shkeljesh të kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, gjatë ushtrimit të detyrës së saj si gjyqtare, si dhe shkelje që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës së saj si Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Komisioni²⁹ i ka kërkuar denoncueses që të depozitojë dokumentacion mbështetës për pretendimet e saj.

Denoncuesja A.K.³⁰, ka depozituar një listë me dokumente të fotokopjuara. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesja dhe subjekti, si dhe nga shpjegimet e saj, Komisioni vëren se, denoncuesja nuk mundi të provojë pretendimet e saj. Megjithatë, është e qartë se ka një konflikt personal ndërmjet kancelares dhe kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Konflikti ndërmjet subjektit të rivlerësimit në funksionin e kryetares së gjykatës dhe kancelares së kësaj gjykate, reflektohet në marrëdhëniet e tyre të punës, të cilat janë aktualisht mosfunksionale. Kjo situatë që vazhdon prej kohësh por që nuk është në kompetencat e Komisionit për ta zgjidhur, është e pa tolerueshme dhe rezulton në shërbim të dobët për qytetarët, që ofron Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Trupi gjykues ka konkluduar se, konflikti ndërmjet Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe kancelares së gjykatës është një tregues për një frymë jo bashkëpunuese brenda këtij institucioni dhe është një çështje e cila duhet zgjidhur sa më shpejt për të mos patur pasoja në mbarëvajtjen normale të insitucionit dhe në përmbushjen e detyrave të gjithësecilit.

Denoncimi i depozituar pranë Komisionit nga kancelarja e gjykatës dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit dhe të gjitha provat e depozituara nga secila palë, do t'i kalohen për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor, për trajtim dhe zgjidhje sa më të shpejtë.

Denoncim nr. 6³¹, depozituar nga z. P. D. Ll.

Denoncuesi ka depozituar denoncim për 22 subjekte rivlerësimi ndërmjet të cilëve dhe për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari. Objekti i denoncimit: “Shpërdorim detyre me dashje, fshehje, krim i organizuar dhe mafien e tokave”.

Trupi gjykues vlerëson se, denoncuesi nuk ka deklaruar dhe nuk ka depozituar asnjë provë apo dokument që të përbëjë indice për shkelje të ligjit nga subjekti i rivlerësimit, në përputhje me nenin 53, pika 2, e ligjit nr. 84/2016.

Denoncim nr. 7³², depozituar nga z. Gj. D.

Denoncuesi ka paraqitur disa denoncime për subjektin e rivlerësimit, për disa vendime gjyqësore të marra nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht për vendimin e marrë nga subjekti me palë paditëse: P.D. të paditur: Agjencia e Trajtimit të pronave, Tiranë. Sipas denoncuesit pretendohet se vendimi që ka marrë trupi gjykues (ndërmjet të cilëve dhe subjekti i rivlerësimit) është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është dërguar për rigjykim me një tjetër trupë gjykuese.

Komisioni nga verifikimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe atë të Gjykatës së Apelit, ka rezultuar se çështja në shqyrtim është çështje themeli, e cila është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për shkak se në shqyrtimin e saj në Gjykatën e Lezhës nuk ishte formuar drejtë ndërgjyqësia e palëve e për pasojë çështja e

²⁹ me shkresën nr. *** prot., datë 29.01.2019.

³⁰ me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2019.

³¹ me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2019.

³² me shkresën nr. *** prot., datë 13.02.2019.

pronësisë nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare për palët. Për pasojë Gjykata e Apelit Shkodër e ka kthyer çështjen për rigjykim me një tjetër trup gjykues.

Trupi gjykues vlerëson se, pretendimet e denoncuesit i takojnë themelit të çështjet e për pasojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Janë gjykatat e një shkalle më lartë që gjykojnë vendimmarrjen e një gjykate të shkallës më të ulët.

Denoncim nr. 8³³, depozituar nga z. Gj. P.

Denoncuesi ka pretenduar se subjekti ka favorizuar duke i dhënë një sipërfaqe tokë truall 20.4 m², palës së paditur R. Gj., etj mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara. Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendimin ndërkohë që çështja ishte në hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Denoncuesi ka depozituar vendimin e dhënë nga subjekti si dhe disa dokumente shoqëruese.

Pasi subjekti i rivlerësimit është njohur me këtë denoncim, me shkresën nr. ***prot., datë 18.03.2019, ka depozituar vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër me nr. ***, datë 06.07.2018. Nga vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton se, kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, marrë nga subjekti.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vendimin për të cilin denoncuesi ka paraqitur pretendime është shqyrtuar tashmë nga Gjykata e Apelit Shkodër e cila ka shqyrtuar zbatimin e ligjit nga një shkallë më e ulët.

Denoncim nr. 9³⁴, depozituar nga z. A.K.

Në këtë denoncim të tretë kancelaria i referohet disa deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore duke i kundërshtuar ato. Kancelaria gjithashtu deklaroi se disa ditë përpara seancës, znj. Ornela Naqellari, ka depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Lezhë kundër ish kryesekretares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhës duke pretenduar për “shpërdorim detyre”. Kancelaria pretendon se kjo është bërë vetëm për arsye të *vettingut* nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Komisioni vlerëson se, ky denoncim nuk plotëson kërkesat e nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

Denoncim nr. 10³⁵, depozituar nga z. Gj.D.

Denoncuesi ka parashtruar faktin se subjekti i rivlerësimit ka qëndruar/fjetur në një hotel në Lezhë, pronar i të cilit është një person i cili ka qenë palë ndërgjyqëse në një proces gjyqësor të shqyrtuar nga subjekti. Denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka paguar për shërbimin e hotelierisë në hotelin e personit të cilit i ka bërë gjyqin. Denoncuesi pretendon se gjyqi është zgjidhur në favor të pronarit të hotelit.

Vetë subjekti në seancën dëgjimore ka deklaruar se pronari i hotelit nuk ka qenë palë ndërgjyqëse, pasi referuar ekstraktit të QKB-së, pronarët e hotelit janë persona të tjerë, të ndryshëm nga ky person.

³³ me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019.

³⁴ me shkresën nr. *** prot., datë 15.03.2019 dhe datë 13.03.2019.

³⁵ me *e-mail-in* e datës 17.03.2019.

Nga verifikimi i çështjes, sipas regjistrimeve pranë QKB-së, pronarët e hotelit rezultojnë persona të ndryshëm nga pala ndërgjyqëse që pretendohej nga denoncuesi, i cili ishte favorizuar nga subjekti. Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna, që të konkludojë që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ka qenë e ndikuar nga marrëdhënie interesi.

Më datë 15.03.2019, z. Gj. D., ka depozituar sërish një denoncim tjetër ku pretendon se subjekti i rivlerësimit ka qëndruar edhe tek një tjetër hotel i quajtur “J. H”, i cili ndodhet në qendër të Lezhës. Pronari i këtij hoteli quhet Gj. T. Denoncuesi pretendon se ajo ka dhënë një vendim në favor të pronarit të “J. H”, datë më 28.07.2017 dhe se ajo ka qëndruar atje bashkë me të fejuarin për të zgjidhur çështjen. Nga denoncuesi nuk u paraqiten prova mbështetëse.

Komisioni vlerëson se, ky denoncim nuk plotëson kërkesat e nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

Denoncim nr. 11, nga z. A. M. me nr. *prot., datë 19.03.2019.**

Denoncuesi depoziton denoncimin me objekt “Paaftësi profesionale pasi ka përdorur në gjykim si provë dokumente të falsifikuara”. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim mbi dokumente të falsifikuara të vërtetuara nga prokuroria, si dhe nuk priti që të pezullonte gjykimin ndërkohë që çështja ishte në ndjekje penale. Sipas denoncuesit vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit është i njëanshëm.

Komisioni vlerëson se, ky denoncim nuk është paraqitur në përputhje me nenin 53, pika 2, e ligjit nr. 84/2016.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit me shkresën nr. *** prot., datë 19.03.2019, në lidhje me denoncimet e cituara më sipër me nr. 8, 9 dhe 10, ka paraqitur “Opinion” ku ndër të tjera shprehet se, asnjë prej këtyre denoncimeve nuk plotëson kërkesat e nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, pasi ato nuk sigurojnë:

- 1) Një bazë të nevojshme për të për të vlerësuar shkeljen ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit;
- 2) Të dhëna specifike për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme. Nuk gjeta asnjë indice apo element që cenon figurën e gjyqtarës, znj. Ornela Naqellari, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, kështu që për subjektin e rivlerësimit propozoj: “E aftë”.

V. KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi

dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Naqellari, me funksion gjyqtare/Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 21.03.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine
Kryesuese

Suela Zhegu
Relatore

Brunilda Bekteshi
Anëtare

Etmonda Hoxha
Sekretare gjyqësore